

UDHËZIM
Nr. 13, datë 19.12.2006

**PËR CAKTIMIN DHE PËRGATITJEN E VENDIT TË NUMËRIMIT TË VOTAVE,
DHE MËNYRËN E NGRITJES SË GRUPEVE TË NUMËRIMIT**

(Ndryshuar me udhëzimin nr. 2, datë 18.1.2007)

(i përditësuar)

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 29 pika 1, nenit 95, nenit 95/1, nenit 95/2, nenit 109/3, nenit 109/4, nenit 109/5 dhe nenit 109/6 të ligjit nr. 9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

UDHËZON:

PJESA I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë rregullat për caktimin e vendndodhjes së vendit të numërimit të votave (VNV), përgatitjen e tyre, si dhe të rregullojë mënyrën e ngritjes, organizimit dhe funksionimit të grupeve të numërimit (GN).

PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 2

1. KZQV-ja organizon dhe përgatit vendin e numërimit të votave.
2. Vendndodhja e VNV-së caktohet me vendim të KQZ-së, mbi bazën e propozimit të paraqitur nga komisioni i zgjedhjeve për qeverisjen vendore.
3. Grupi i numërimit është përgjegjës për numërimin dhe vlerësimin e votave, si dhe për plotësimin e tabelave të rezultateve për çdo qendër votimi.
4. Grupet e numërimit ngrihen me vendim të KZQV-së. Propozimet për anëtarët e GN-së bëhen nga partitë politike, që kanë propozuar anëtarët e KZQV-ve. Anëtarët e GN-së caktohen nga KZQV-ja, sipas modelit tip të vendimit të miratuar nga KQZ-ja.

Neni 3

1. Vendi i numërimit të votave caktohet si rregull në ndërtesa publike si: pallat sporti, pallat kulture, qendër kulturore e fëmijëve, palestra sportive, salla kinemaje, ambiente shkollash etj.
2. Vendi i numërimit të votave mund të caktohet në ndërtesa private vetëm me vendim të veçantë të KQZ-së.

PJESA II
CAKTIMI I VENDNDODHJES SË VENDIT TË NUMËRIMIT TË VOTAVE (VNV)

Neni 4
Vendndodhja e VNV-së

1. Vendndodhja e VNV-së caktohet me vendim të KQZ-së, mbi bazën e propozimit të paraqitur nga komisioni i zgjedhjeve për qeverisjen vendore përkatëse, sipas modelit të miratuar nga KQZ-ja.

2. Vendndodhja e vendit të numërimit të votave si rregull caktohet sa më afër vendit, ku është ngritur zyra e KZQV-së.

3. Vendndodhja e VNV-ve të njësive bashkiake të Tiranës duhet të jetë brenda territorit administrativ të këtyre njësive.

Neni 5

Kritere teknike të VNV-së

1. Vendi i numërimit të votave, i përzgjedhur nga komisioni i zgjedhjeve për qeverisjen vendore, duhet të plotësojë të paktën kriteret e mëposhtme teknike:

a) Për njësitë zgjedhore të cilat kanë në përbërje të tyre mbi 20 qendra votimi, sipërfaqja e ambientit të VNV-së, si rregull, duhet të jetë jo më e vogël se 200 m².

b) Për njësitë zgjedhore të cilat kanë në përbërje të tyre 15 deri 20 qendra votimi, sipërfaqja e ambientit të VNV-së, si rregull, duhet të jetë jo më e vogël se 100 m².

c) Për njësitë zgjedhore të cilat kanë në përbërje të tyre deri në 15 qendra votimi, sipërfaqja e ambientit të VNV-së, si rregull, duhet të jetë jo më e vogël se 50 m².

d) Të ketë sistem të siguruar ndriçimi, të mjaftueshëm dhe të pandërprerë si në mjediset e brendshme, ashtu edhe përreth godinës.

e) Për aq sa është e mundur, të ketë më shumë se një derë komunikuese me mjedisin e jashtëm.

f) Të jetë e pajisur me mjete të mbrojtjes kundër zjarrit, si dhe të ndihmës së shpejtë.

2. Propozimi duhet të shoqërohet me skicën përkatëse të ambientit.

Neni 6

Organizimi i vendit të numërimit të votave

(Ndryshuar shkronjat "a" dhe "b" të pikës 4 me udhëzimin nr. 2, datë 18.1.2007)

1. KZQV-ja organizon dhe përgatit VNV, në mënyrë të tillë që të garantojë zhvillimin normal të punës për numërimin e votave.

2. KZQV-ja organizon hapësirën e VNV në mënyrë të tillë, që të jetë e ndarë në mënyrë të qartë nga hapësira për vëzhguesit, kandidatët dhe mediat, por në çdo rast pa cenuar mundësinë e ndjekjes nga afër të procesit të numërimit.

3. Organizimi fizik i hapësirës në dispozicion të çdo GN-je, duhet të bëhet në mënyrë të tillë, që të pengojë ndërhyrjen e personave të tjerë të pranishëm në VNV.

4. Në çdo rast, KZQV-ja në bashkëpunim me organet e qeverisjes vendore, jo më vonë se pesë ditë para ditës së zgjedhjeve, bën rregullimin e VNV sipas planvendosjes orientuese bashkëlidhur këtij udhëzimi, si edhe vendos pajisjet logjistike të nevojshme për kryerjen e procesit të numërimit, si më poshtë:

a) *Tavolina pune dhe 14 karrige për KZQV-në;*

b) *Treshe tavolinash (vendosen në formë T-je sipas shpjegimit në skemën orientuese) me nga 14 karrige për çdo grup të numërimit të votave*

c) strukturën ndarëse të hapësirës për publikun me hapësirën për numërimin e votave;

ç) tabelat treguese të dërguara nga KQZ-ja;

d) tabelat treguese për drejtimin e lëvizjes në mjediset e brendshme të VNV.

PJESA III

NGRITJA E GRUPEVE TË NUMËRIMIT

Neni 7

Caktimi i numrit të grupeve të numërimit

(Shtuar paragrafë në pikën 6 , ndryshuar pika 7, shtuar pika 8 me udhëzimin nr. 2, datë 18.1.2007)

1. Çdo KZQV cakton me vendim ngritjen e grupeve të numërimit.
2. Në njësitë zgjedhore të cilat kanë deri në 5 qendra votimi, KZQV-ja cakton ngritjen e një grupi numërimi.
3. Në njësitë zgjedhore të cilat kanë nga 6 deri në 10 qendra votimi, KZQV-ja cakton ngritjen e dy Grupeve Numërimi.
4. Në njësitë zgjedhore të cilat kanë nga 11 deri në 15 Qendra Votimi, KZQV-ja cakton ngritjen e tri grupeve numërimi.
5. Në njësitë zgjedhore të cilat kanë nga 16 deri në 20 qendra votimi, KZQV-ja cakton ngritjen e katër grupeve numërimi.
6. Në njësitë zgjedhore të cilat kanë mbi 20 qendra votimi, KZQV-ja cakton ngritjen e pesë grupeve numërimi.
 - I.
 - A) Në bashkitë, të cilat kanë nga 2 deri 8 qendra votimi, KZQV-ja cakton ngritjen e një grupi numërimi;
 - B) Në bashkitë, të cilat kanë nga 9 deri në 14 qendra votimi, KZQV-ja cakton ngritjen e dy grupeve të numërimit;
 - C) Në bashkitë, të cilat kanë nga 15 deri në 19 qendra votimi, KZQV-ja cakton ngritjen e tri grupeve të numërimit;
 - D) Në bashkitë, të cilat kanë nga 20 deri në 29 qendra votimi, KZQV-ja cakton ngritjen e katër grupeve të numërimit;
 - E) Në bashkitë, të cilat kanë nga 30 deri në 45 qendra votimi, KZQV-ja cakton ngritjen e pesë grupeve të numërimit;
 - F) Në bashkitë, të cilat kanë nga 46 deri në 70 qendra votimi, KZQV-ja cakton ngritjen e tetë grupeve të numërimit;
 - G) Në bashkitë, të cilat kanë nga 71 deri në 100 qendra votimi, KZQV-ja cakton ngritjen e dhjetë grupeve të numërimit;
 - H) Në njësitë bashkiake të Tiranës, KZQV-ja cakton ngritjen e dhjetë grupeve të numërimit;
 - I) Në bashkinë Durrës, KZQV-ja cakton ngritjen e dymbëdhjetë grupeve të numërimit.
 - II.
 - A) Në komunat, të cilat kanë 2 deri 9 qendra votimi, KZQV-ja cakton ngritjen e një grupi numërimi;
 - B) Në komunat, të cilat kanë 10 deri 15 qendra votimi, KZQV-ja cakton ngritjen e dy grupeve të numërimit;
 - C) Në komunat, të cilat kanë 16 deri 19 qendra votimi, KZQV-ja cakton ngritjen e tri grupeve të numërimit;
 - D) Në komunat, të cilat kanë 20 deri 30 qendra votimi, KZQV-ja cakton ngritjen e katër grupeve të numërimit.
7. Çdo grup numërimi përbëhet nga 13 anëtarë dhe sekretari.
8. Në të gjitha rastet, KZQV-ja duhet të ketë parasysh se një grup numërimi numëron jo më pak se 5 qendra votimi dhe jo më shumë 15 qendra votimi.

Neni 8

Emërimi i anëtarëve të grupeve të numërimit

(Ndryshuar pika 1, shtuar paragrafë në pikat 3 dhe 4 me udhëzimin nr. 2. datë 18.1.2007)

1. Dhjetë ditë përpara ditës së zgjedhjeve, KZQV-ja njofton subjektet zgjedhore përkatëse të paraqesin propozimet për anëtarë të GNV-ve. KZQV-ja merr vendim për caktimin e grupeve të numërimit dy ditë para datës së zgjedhjeve.

2. Propozimi për emrat e anëtarëve të GN i paraqitet KZQV-së nga personi i autorizuar nga kryetari i partisë, që ka të drejtë të bëjë propozimin.

3. Partia politike, e cila ka propozuar zëvendëskryetarin e KZQV-së, ka të drejtën të paraqesë propozime për dy anëtarë të grupit të parë të numërimit, njëri prej të cilëve caktohet nga KZQV-ja, kryetar i këtij grupi numërimi.

Në rastin kur zëvendëskryetari i KZQV-së është propozuar nga Partia Socialiste, ajo ka të drejtë të paraqesë propozime për tre anëtarë të grupit të parë të numërimit, njëri prej të cilëve caktohet nga KZQV-ja, kryetar i këtij grupi numërimi.

4. Partia politike, e cila ka propozuar kryetarin e KZQV-së, ka të drejtën të paraqesë propozime për dy anëtarë të grupit të dytë të numërimit, njëri prej të cilëve caktohet nga KZQV-ja, kryetar i këtij grupi numërimi. Me këtë radhë vazhdohet me grupet e tjera të numërimit.

Në rastin kur kryetari i KZQV-së është propozuar nga Partia Socialiste, ajo ka të drejtë të paraqesë propozime për tre anëtarë të grupit të dytë të numërimit, njëri prej të cilëve caktohet nga KZQV-ja, kryetar i këtij grupi numërimi

Neni 9

Partitë politike duhet të paraqesin edhe një listë rezervë me anëtarë të grupeve të numërimit, në rastet kur anëtarët e GN-ve duhet të zëvendësohen, për shkak të lodhjes fizike apo për shkaqe të tjera.

Neni 10

Zëvendësimi i anëtarëve të grupit të numërimit

1. Në rast se një parti politike nuk paraqet propozim brenda afatit kohor të përcaktuar në nenin 95/2 pika 1 të Kodit Zgjedhor, KZQV-ja me vendim cakton anëtarin zëvendësues.

2. Zëvendësuesi caktohet me short ndërmjet anëtarëve të KQV-ve të njësisë zgjedhore përkatëse, të emëruar me propozim të së njëjtës parti politike.

3. Procedura e shortit është si më poshtë:

a) Sekretari i KZQV-së përgatit dhe vendos në një enë një numër të barabartë shiritash letre me numrin e qendrave të votimit në njësinë e qeverisjes vendore. Secili nga shiritat e letrës ka të shënuar numrin e një qendre votimi.

b) Kryetari i KZQV-së tërheq njërin nga shiritat e letrës dhe lexon numrin e qendrës së votimit të shënuar në të.

c) Anëtari i kësaj KQV-je, i emëruar me propozim të partisë politike për të cilën hidhet shorti, caktohet anëtar i grupit të numërimit.

d) Kryetari i KZQV-së tërheq shirita letre në numër të barabartë me numrin e grupeve të numërimit që do të ngrihen.

e) Në rastet kur shorti hidhet si pasojë e mosparaqitjes së propozimeve nga një parti politike, e cila ka paraqitur propozime për emërimin e dy anëtarëve të KQV-së, atëherë pas çdo tërheqje shiriti letre me numrin e QV-së, kryetari i KZQV-së hedh short me monedhë, për të caktuar se cili nga dy anëtarët e KQV-së do të caktohet në grupin e numërimit. Procedura vazhdon e njëjtë derisa të plotësohen vendet e mbetura bosh.

4. Në rastet kur vendi i një anëtari të Grupit të Numërimit mbetet vakant gjatë procesit

të numërimit të votave, partia politike e cila kishte propozuar anëtarin paraqet menjëherë propozimin e ri.

5. Nëse partia politike nuk paraqet propozimin për plotësimin e vendit të mbetur bosh brenda 1 ore, KZQV-ja zbaton procedurën e shortit sipas pikës 3 të këtij neni.

PJESA IV GRUPI I NUMËRIMIT TË VOTAVE

Neni 11

Kryetari dhe zv.kryetari i Grupit të Numërimit

1. Kryetari i GN është përgjegjës për drejtimin e procedurave për numërimin dhe vlerësimin e votave, si dhe për hartimin e tabelave të rezultateve të qëndrës së votimit.

2. Kryetar i Grupit të Numërimit me numër tek, caktohet personi i propozuar nga Partia politike, e cila ka propozuar zëvendëskryetarin e KZQV-së.

3. Kryetar i Grupit të Numërimit me numër çift caktohet personi i propozuar nga partia politike, e cila ka propozuar Kryetarin e KZQV-së. Me këtë radhë vazhdohet me grupet e tjera.

4. Zëvendëskryetari i Grupit të Numërimit i përket partisë politike më të madhe të spektrit të kundërt me kryetarin.

Neni 12

Sekretari i grupit të numërimit

Sekretari i GN-së caktohet nga KZQV-ja me propozim të subjektit politik që ka paraqitur edhe propozimin për caktimin e zëvendëskryetarit të të njëjtit GN.

Neni 13


Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.



PLANVENDOSJE ORIENTUESE

E
VENDIT TE NUMERIMIT TE VOTAVE

EMERTIMI	NJESIA SASIA
TAVOLINA PUNE	Cope 12
KARRIGE	Cope 60 (max)
SHIRIT NDARES	Meter 50 (max)
FAKS	Cope 1
TABELA SQAUESE	Cope 10



SHPJEGIME MBI PLANVENDOSJEN ORIENTUESE TË VENDIT TË NUMËRIMIT TË VOTAVE

1. Kjo planvendosje do t'u vijë në ndihmë për organizimin e brendshëm të vendit të numërimit të votave.

2. Pavarësisht se sa grupe numërimi do të ngrini, për aq sa është e mundur, mundohuni që organizimi i brendshëm i VNV-së të bëhet sipas kësaj planvendosjeje.

3. Ndani fillimisht hapësirën brenda të cilës do të zhvillohet procesi i numërimit, duke vendosur panelet ndarëse të dërguara nga KQZ-ja.

4. Brenda kësaj hapësire, përcaktoni vendin ku do të vendoset tavolina e punës së KZQV-së, vendi ku do të vendosen kutitë e votimit dhe kutia e materialeve zgjedhore para numërimit dhe pas numërimit, sipas kësaj ideje:

- Tavolina e KZQV-së vendoset në mes. Në të majtë të saj vendosen kutitë e votimit dhe kutia e materialeve të votimit para numërimit dhe në të djathtë të saj kutitë e votimit dhe ajo e materialeve zgjedhore pas numërimit.

- Vendosni kutitë në pozicion vertikal, në mënyrë që në fillim të jetë kutia e votimit për këshillin, pastaj kutia e votimit për kandidatët dhe në krye kutia e materialeve zgjedhore.

- Brenda kësaj hapësire mendoni për një vend ku do të vendosni kutitë e vlerësuara të parregullta gjatë procesit të marrjes në dorëzim nga KQV-të.

- Tregoni kujdes që kutitë e votimit dhe ajo e materialeve zgjedhore të jenë të ruajtura dhe të mos preken nga persona të paautorizuar.

5. Tavolina e çdo grupi numërimi vendoset në formë T-je: në pjesën vertikale (gjatësore) vendosen dy tavolina bashkë me qëllim që gjerësia e suprinës të jetë e mjaftueshme dhe fletët e votimit të mos bien në tokë, ndërsa në pjesën horizontale vendoset vetëm një tavolinë.

6. Anëtarët e GN-së ulen sipas mënyrës që paraqitet në planvendosjen orientuese.

7. Përcaktoni vendin ku do të vendosen vëzhguesit dhe media.

8. Largësia nga tavolina e punës së GN-së dhe vëzhguesve (e ndarë me panelet ndarëse) duhet të jetë e tillë që të mundësojë vëzhgimin normal të procesit të numërimit, por duke shmangur kontaktin fizik midis vëzhguesve dhe anëtarëve të GN-së.

9. Tregoni kujdes që në VNV të mos ketë persona të tjerë të paautorizuar nga KZQV-ja.

10. Përcaktoni mënyrën e lëvizjes brenda hapësirës ku kryhet numërimi, me qëllim që çdo procedurë të kryhet me rregull dhe pa rrëmujë.

11. Siguroni që procesi i numërimit të kryhet me qetësi dhe me rregull.